

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Broshurë 3-mujori i Dytë
Prill - Qershor 2026



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE





DIMENSIONI I MJEDISIT

Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR) është një shtyllë e rëndësishme e angazhimit të sektorit bankar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, duke reflektuar rolin e bankave si kontribues aktivë në mirëqenien sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjatë periudhës prill – qershor 2026, sektori bankar vijoi të mbështesë iniciativë me ndikim në komunitet, duke investuar në projekte që nxisin përfshirjen sociale, edukimin, mbrojtjen e mjedisit, kulturën, shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Këto iniciativë pasqyrojnë një qasje afatgjatë ndaj përgjegjësisë korporative, të bazuar në partneritete me institucione publike, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, me synim krijimin e ndikimit pozitiv dhe të matshëm për komunitetin dhe ekonominë shqiptare.

MJEDISI

EKONOMIA

SHOQËRIA



ProCredit Bank



BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI:

- Organizoi një aktivitet edukativ në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Tokës, në bashkëpunim me Grupin Intesa Sanpaolo, ku nxënësit e klasës së katërt mësuan mbi qëndrueshmërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë qarkulluese dhe transportin e së ardhmes, përmes një moduli interaktiv të përgatitur nga Muzeu i Kursimeve në Torino dhe Banka Evropiane e Investimeve.
- Vlerësoi suksesin e maturantëve të gjimnazit “Sami Frashëri” në konkursin ndërkombëtar “S.A.V.E. International Ambassadors”, ku projekti i tyre “Green Points Tirana” u rendit i pari mes gjimnazeve pjesëmarrëse në Tiranë dhe fitoi vendin e tretë në nivel ndërkombëtar.
- Organizoi aktivitetin edukativ “Young Green Advocates” në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, ku fëmijët e punonjësve morën pjesë në aktivitete interaktive me vizatime, lojëra dhe diskutime mbi mbrojtjen e mjedisit.

BANKA OTP SHQIPËRI:

- Organizoi një aksion pastrimi në Vilëbashtovë përmes Korpusit Vullnetar “Green Hearts”, ku punonjësit e bankës mbledhën mbi 20 qese me mbeturina, duke ndërgjegjësuar për ruajtjen e hapësirave natyrore.

BANKA PROCREDIT SHQIPËRI:



- U përfaqësua në panelin “Financimi Klimatik për Inovacion dhe Përshtatje” në kuadër të konferencës “United for Climate – Regional Cooperation for a Resilient Future”, ku ndau eksperiencën e saj mbi financimin e gjelbër dhe rolin e sektorit bankar në mbështetjen e tranzicionit drejt një ekonomie të qëndrueshme.

BANKA RAIFFEISEN SHQIPËRI:

- Realizoi një projekt ripyllëzimi në zonën e Liqenit të Dushkut, në Bashkinë Gramsh, ku u mbollën rreth 10,000 fidanë pishe në një sipërfaqe prej 5 hektarësh, duke kontribuar në rigjenerimin e një territori të prekur nga zjarret, rikthimin e ekosistemit dhe mbrojtjen afatgjatë të mjedisit.

BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË (UBA):

- Ndërmori një iniciativë vullnetare në kuadër të Ditës së Tokës, ku stafi i bankës u angazhua për një mjedis më të pastër, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit mjedisor dhe promovimin e përgjegjësisë individuale e institucionale për mbrojtjen e mjedisit.



6 UJË I PASTER DHE KANALIZIME



13 VEPRIM PER KLIMEN



14 JETA NEN UJE



15 JETA NE STERE





DIMENSIONI EKONOMIK

Banka Amerikane e Investimeve (ABI):

Banka Amerikane e Investimeve (ABI):

- Mori pjesë në Panairin “Ditët e Bujqësisë” në Lushnje, ku prezantoi zgjidhje bankare për agrobizneset, individët dhe familjet, duke promovuar përfshirjen financiare të sektorit bujqësor.
- Mbështeti edicionin e katërt të “Automotive Fair Albania”, duke kontribuar në promovimin e inovacionit, teknologjisë dhe ndërgjegjësimit për sigurinë rrugore.
- Ishte Gold Sponsor i Konferencës Vjetore të Qendrës së Mikrofinancës (MFC), duke kontribuar në promovimin e përfshirjes financiare përmes diskutimeve mbi financimin e SME-ve, agrobiznesit dhe sipërmarrjes.
- Mori pjesë në tryezën e diskutimit “Mbrojtja e të Dhënave Personale dhe Inteligjenca Artificiale në Sektorin Financiar”, duke ndarë përvojën e saj mbi zhvillimet teknologjike dhe promovuar praktika të përgjegjshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe besimin e klientëve.
- U angazhua në eventin “B2B & Matchmaking: Connecting Capital with Impact-Driven Businesses”, duke promovuar lidhjet mes sektorit financiar dhe sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe partneritetet strategjike për zhvillimin e bizneseve me ndikim ekonomik, social dhe mjedisor.

Banka Kombëtare Tregtare (BKT):

- Mbështeti kompeticionin “Young Innovators 2026”, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive profesionale të mbi 443 studentëve, promovimin e sipërmarrjes dhe inovacionit, si dhe nxitjen e zgjidhjeve për sfidat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Banka Credins:

- Prezantoi produktin “AgroInvest” në kuadër të Panairit “Agro/ Ditët e Bujqësisë” në Lushnje, duke promovuar zgjidhje financimi me kushte të përshtatura sipas nevojave dhe mbështetur zhvillimin e sipërmarrjes dhe sektorit bujqësor në Shqipëri.
- Nënshkroi një marrëveshje të re garancie në kuadër të programit EU Western Balkans Guarantee, duke forcuar aksesin në financim për sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSME).



DIMENSIONI EKONOMIK

Banka e Parë e Investimeve Shqipëri (Fibank):

- Komunikoi gjatë muajit maj 2026 rezultatet rekord të vitit 2025, duke evidencuar rritjen e aktiveve, depozitave, kreditimit dhe fitimit neto, si dëshmi e kontributit në zgjerimin e qasjes në financim dhe zhvillimin ekonomik.
- Prezantoi zgjidhjet e saj të financimit në konferencën “Vlera e Pronës II”, duke ofruar produkte të dedikuara për financimin e pronave, përfshirë kreditë hipotekare për emigrantë dhe shtetas të huaj.
- U angazhua si “Silver Sponsor” i AI Business Summit II, duke promovuar inovacionin, transformimin digjital dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në funksion të zhvillimit të një ekonomie më konkurruese dhe moderne.
- Mori pjesë në aktivitetet e karrierës të Universitetit Epoka dhe Fakultetit të Ekonomisë në Tiranë, duke prezantuar mundësitë e punësimit, programet e praktikës profesionale dhe perspektivat e zhvillimit në sektorin bankar, si dhe duke bashkëbiseduar me studentët mbi rugëtimin profesional.

Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri:

- Nënshkroi një marrëveshje financimi prej 20 milionë euro me Grupin e Bankës Europiane të Investimeve (BEI), për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në inovacion, transformimin digjital dhe tranzicionin e gjelbër, përmes financimit me kushte të favorshme.

Banka OTP Shqipëri:

- Mbështeti dhe mori pjesë në eventin “Mjeshtëro Biznesin”, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, promovimin e kulturës së të mësuarit të vazhdueshëm dhe forcimin e bashkëpunimit mes profesionistëve dhe ekosistemit të biznesit.

Banka ProCredit Shqipëri:

- Zgjeroi partneritetin me Albanian Development Guarantee Foundation (ADGF) në kuadër të Programit të Garancisë BE-KfW për Ballkanin Perëndimor, duke forcuar aksesin në financim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe mbështetur zhvillimin ekonomik e konkurrueshmërinë e tyre.
- U përfaqësua në panelin “Promoting Women’s Access to Climate Finance”, në diskutimet mbi rritjen e qasjes të grave në financimin e qëndrueshëm dhe rolin e sektorit bankar në promovimin e investimeve gjithëpërfshirëse dhe tranzicionit të gjelbër.
- Mirëpriti vizitën e përfaqësuesve të European Investment Bank në biznesin partner LeBon Tirana, duke vënë në pah rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare për mbështetjen e bizneseve lokale, investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës.
- U përfaqësua në “Balkonnnect Festival 2026”, në diskutimet mbi



besimin në financat digjitale, zhvillimin e kanaleve digjitale, inovacionin dhe bashkëpunimin për ndërtimin e një ekosistemi financiar të sigurt dhe të qëndrueshëm.

- Mbështeti programin “Women Startup Albania 2026”, i cili promovon sipërmarrjen e grave përmes mentorimit, trajnimeve dhe qasjes në financim, duke krijuar mundësi për zhvillimin e startup-eve inovative dhe rritjen e bizneseve të drejtuara nga gratë në Shqipëri.
- Mori pjesë në Panairin e Punës në Universitetin Epoka, ku prezantoi mundësitë për praktika dhe punësim në sektorin bankar.

Union Bank:

- Nënshkroi me BERZH marrëveshjen për Linjën e Kredisë Revolving në kuadër të Programit të Lehtësimit të Tregtisë (TFP), duke krijuar mundësi të reja financimi për eksportuesit, importuesit dhe distributorët vendas.
- Organizoi në partneritet me BERZH eventin “Finance Your Future Digitally”, duke promovuar transformimin digjital, përfshirjen financiare dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të drejtuara nga të rinjtë, përmes mbështetjes financiare dhe jo-financiare për bizneset e vogla dhe të mesme.
- Mbështeti për të pestin vit Forumin e Lidershitipit “Lidershipi Vizionar në epokën e Inteligjencës Artificiale”, duke kontribuar në diskutimet mbi transformimin digjital, përdorimin e inteligjencës artificiale dhe rolin e lidershitipit në përballimin e sfidave të reja ekonomike.
- Organizoi në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike të Gruas trajnimin “Këshillim financiar për gratë sipërmarrëse”, duke promovuar edukimin financiar, qasjen në shërbime bankare dhe fuqizimin e grave në biznes përmes këshillimit dhe mbështetjes për zhvillimin e qëndrueshëm të sipërmarrjeve të tyre.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA):

- Mori pjesë në Panairin e Punës 2026 në Universitetin “Marin Barleti” dhe Universitetin “Qiriazi”, duke prezantuar mundësitë e karrierës në sektorin bankar, krijuar kontakte me studentët dhe promovuar zhvillimin profesional e investimin në kapitalin njerëzor.



SHOQËRIA

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE (ABI):

- Iu bashkua festimeve të 250-vjetorit të Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke ndriçuar godinën e saj me ngjyrat e flamurit amerikan dhe duke reflektuar vlerat e partneritetit, bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të qëndrueshme mes dy vendeve.
- U angazhua si partneri kryesor i Pavijonit Shqiptar në edicionin e 61-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit, La Biennale di Venezia, duke kontribuar në promovimin e artit dhe kulturës shqiptare në arenën ndërkombëtare përmes mbështetjes së veprës “A Place in the Sun” të artistit Genti Korini.
- U angazhua si sponsor i dy mbrëmjeve artistike në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit, me interpretimin e violinistit me famë ndërkombëtare Tedi Papavrami, duke kontribuar në promovimin e artit, kulturës dhe pasurimin e jetës kulturore në Shqipëri.

BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT):

- Mbështeti edicionin 2026 të “DOA – Durrës Opera Art of Singing”, duke kontribuar në pozicionimin e Durrësit si qendër për formimin e artistëve të rinj.
- Mbështeti konkursin akademik “Doktorata ime në 3 minuta”, duke kontribuar në zhvillimin profesional të kërkuesve të rinj, si dhe në forcimin e kulturës së inovacionit dhe bashkëpunimit në arsimin e lartë.
- Kontribuoi në aktivitetin e organizuar për fëmijët e ushtarakëve me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, duke mbështetur mirëqenien e fëmijëve, përfshirjen sociale, barazinë gjinore dhe solidaritetin me familjet e personave të rënë në krye të detyrës.

BANKA CREDINS:

- Ralizoi “Projektin Veror Credins 2026” në bashkëpunim me Mastercard, duke sjellë një seri eventesh dhe aktiviteteve kulturore e argëtuese, përfshirë Zamna Festival, UNUM Festival dhe FunZone 2026.
- Vijoi traditën e organizimit të ekspozitave artistike në hollin e bankës, duke mbështetur artistët vendas dhe krijuar mundësi për prezantimin e veprave të tyre përmes ekspozitave “Rikthim” nga Abaz Hado dhe “Peizazh Ëndërrues” nga Pashk Pervathi.






- Mbështeti kompeticionin “Sali Nallbani Open 2026”, duke kontribuar në promovimin e sportit të tenisit, si dhe në zhvillimin e talenteve të reja përmes turneve të dedikuara për grupmosha të ndryshme.
- U bë pjesë e programit “Drejtues për një Ditë” të organizuar nga Junior Achievement of Albania, duke mirëpritur një nxënëse maturante për të njohur nga afër funksionimin e një institucioni financiar, rolet drejtuese, rëndësinë e bashkëpunimit dhe vlerat e përgjegjësisë korporative.

BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI (FIBANK):

- Mbështeti performancën e violinistit Ray Chen në Teatrën Kombëtar të Operës dhe Baletit, duke sjellë një përvojë artistike të nivelit të lartë për publikun shqiptar.
- U angazhua si Sponsor Gjeneral i koncertit gala në Teatrën Kombëtar të Operës dhe Baletit, përmes një aktiviteti që solli së bashku artistë shqiptarë dhe ndërkombëtarë.
- Ishte sponsor zyrtar i platformës Muse-X, duke kontribuar në zhvillimin e bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar, industrisë kreative dhe lidhjes mes artit, biznesit dhe komunitetit.
- Mbështeti ekspozitën “Avant Premiere” në GALERIAKALO, me vepra të përzgjedhura nga Fondazione Archives Legales Amedeo Modigliani.
- Sponsorizoi një event inovativ të organizuar nga Canadian Institute of Technology (CIT), duke kontribuar në mbështetjen e talenteve të reja, zhvillimin e aftësive digjitale, nxitjen e inovacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.



BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI:

- Organizoi një aktivitet edukativ mbi sigurinë kibernetike me nxënësit e shkollës “Emin Duraku”, duke promovuar përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale përmes lojërave, kuizeve dhe moduleve interaktive.
- U bashkua me aktivitetin “Drejtues për një Ditë 2026” të organizuar nga Junior Achievement of Albania, duke mirëpritur një gjimnaziste për të njohur nga afër rolin e një drejtuesi dhe për të zhvilluar orientimin e saj drejt karrierës.
- Organizoi një seancë yoga në natyrë për punonjësit, duke promovuar mirëqenien fizike dhe mendore, reduktimin e stresit dhe forcimin e marrëdhënieve mes kolegëve.
- Ofroi shërbimin CareConnect për punonjësit, një platformë mbështetjeje psikologjike në distancë, anonime, konfidenciale dhe pa pagesë, e aksesueshme 24/7 përmes TELUS Health.
- U përfaqësua në Finalen e Madhe të Sfidës së Gatimit të International Banks Division në Milano, ku kolegja Anela Kulluri prezantoi traditën kulinare shqiptare përmes revanisë karakteristike të Vlorës.
- Ndërgjegjësoi punonjësit në kuadër të Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, përmes një komunikimi të dedikuar mbi rëndësinë e promovimit të dinjitetit, përfshirjes dhe vlerësimit të personave me autizëm.
- U vlerësua si Banka më e mirë në Divizionin e Bankave Ndërkombëtare të Grupit Intesa Sanpaolo për edukimin financiar, ndërsa organizoi në Tiranë takimin e Komitetit të Rrjetit Ndërkombëtar të Edukimit Financiar (FLITIN), duke promovuar përhapjen e edukimit financiar në komunitet.

BANKA OTP SHQIPËRI:

- Mbështeti tenisitë e rinj Jonis dhe Denis Gaba, duke iu siguruar materiale sportive të nevojshme për stërvitjen dhe pjesëmarrjen e tyre në gara sportive brenda dhe jashtë Shqipërisë.

BANKA PROCREDIT SHQIPËRI:

- U ricertifikua sipas standardit ndërkombëtar ISO 14001:2015, duke konfirmuar angazhimin për menaxhimin e përgjegjshëm të ndikimit mjedisor.



BANKA RAIFFEISEN SHQIPËRI:

- Rikonfirmoi për të dytin vit radhazi partneritetin me JunctionX Tirana, duke mbështetur talentet e reja, inovacionin teknologjik dhe zhvillimin e ekosistemit digjital në Shqipëri.
- Mbështeti rikonstruksionin e Qendrës Shëndetësore në fshatin Gorre, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimin e mirëqenies së komunitetit lokal.

TIRANA BANK:

- Mbështeti për të katërtin vit radhazi Festivalin Kombëtar të Sipërmarrjes GEN-E Albania të organizuar nga Junior Achievement Albania, duke kontribuar në zhvillimin e kulturës sipërmarrëse te të rinjtë përmes prezantimit të 26 kompanive studentore me ide inovative në teknologji, bujqësi, ekonomi qarkulluese dhe fusha sociale.

UNION BANK:

- Mbështeti konkursin kombëtar “Të Sigurt mbi Dy Rrota” të organizuar nga “Auto Club Albania-Federata-Automobilizmit”, për edukimin e fëmijëve mbi sigurinë rrugore, rregullat e qarkullimit dhe përdorimin e sigurt të biçikletave përmes aktiviteteve praktike dhe ndërgjegjësuere.
- Sponsorizoi koncertin e violinistit shqiptar me famë ndërkombëtare Olen Cesari, zhvilluar në Pallatin e Kongreseve përgjatë tri netëve.
- Finalizoi projektin “Karta e Studentit Shkodër” në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, duke ofruar për studentët një paketë produktesh dhe shërbimesh bankare me kushte preferenciale.



BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË (UBA):

- U prezantua përmes një interviste të CEO-s së UBA, znj. Bora Feri, në revistën “Monitor”, ku u trajtuan sfidat dhe drejtimet kryesore të sektorit bankar në vitin 2026, me fokus te menaxhimi i riskut, efienca operacionale, transformimi digjital dhe zhvillimi i qëndrueshëm i bankës.
- Iu bashkua festimeve të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, duke mbështetur një aktivitet të dedikuar për fëmijët me lojëra, kreativitet dhe momente argëtuese, në shenjë angazhimi për promovimin e mirëqenies, kujdesit dhe mundësive për brezat e rinj.
- Mori pjesë në Samitin e Diasporës, për forcimin e lidhjeve me komunitetin shqiptar jashtë vendit.
- Mori pjesë në forumin “Healthcare Beyond Borders: Sustainable Growth in Focus” organizuar nga MUSIAD Albania, duke kontribuar në dialogun ndërinstitucional mbi zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e shëndetësisë.
- Mbështeti një studente të dalluar me bursë studimi në bashkëpunim me Canadian Institute of Technology, duke kontribuar në krijimin e mundësive për zhvillimin profesional të brezave të ardhshëm.



Banka Amerikane
e Investimeve (ABI)

Banka
Credins

Banka Intesa Sanpaolo
Shqipëri

Union Bank
Shqipëri

U angazhuan në nisma të dhurimit vullnetar të gjakut në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe organizata të specializuara, duke kontribuar në mbështetjen e fëmijëve talasemikë, pacientëve në nevojë dhe komunitetit. Përmes pjesëmarrjes së punonjësve, bankat promovuan solidaritetin, humanizmin dhe përgjegjësinë sociale ndaj kauzave që kontribuojnë drejtpërdrejt në shpëtimin e jetëve.



Banka Amerikane
e Investimeve (ABI)

Banka
Credins

Banka Intesa Sanpaolo
Shqipëri

Union Bank
Shqipëri

Mbështetën projektin edukativ “Paraja Magjike” në bashkëpunim me SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, duke promovuar edukimin financiar të fëmijëve mbi kursimin, menaxhimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të parasë, si dhe duke kontribuar në mbështetjen e fëmijëve pa kujdes prindëror.

Përmes mbështetjes së botimit dhe shpërndarjes së librit edukativ, bankat kontribuuan në ndërgjegjësimin e brezave të rinj mbi rëndësinë e kulturës financiare që në moshë të hershme. Banka OTP Shqipëri mbështeti botimin e 1,000 kopjeve të librit, ndërsa Union Bank e ofroi atë si dhuratë për fëmijët e stafit me rastin e 1 Qershorit.



Era asnjëherë s’e kishte parë kush ishte kjo “Paraja”, as si dukej, as çfarë mbiemri kishte.
Kërkonte medoemos të njihje atë për të cilën prindërit e saj grindeshin aq shumë...



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Broshurë 3-mujori i Dytë
Prill - Qershor 2026

www.aab.al